



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____._____.2022

VENDIM

Nr. 256, datë 07.07.2022

PËR

CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2, 89 e 97/3 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në nenin 170/1 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

VENDOSI:

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Manjola Xhaxho, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen penale me të pandehur: {...}, {...}; Akuza: Neni 283/a/1 e 22, 333/a/2, 334/1 të Kodit Penal.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, Diamela Goxha, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: Neni 298/3, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal.

GJYKATA E POSAÇME E APELIT PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Shkodër, Valbona Vata, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen penale me të pandehur: {...} ; Akuza: Neni 298/3, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Shkodër, Astrit Kalaja, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen penale me të pandehur: {...}, {...} ; Akuza: Neni 189/2, 190/2 , 298/2-28/4, 333/a/2, 334/1 i Kodit Penal.

II. Një kopje e vendimit t'i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR